

D E K R E T
Nr.919, datë 16.9.1994

PËR DISA NDRYSHIME NË DEKRETIN NR.7393, DATË 12.6.1990 "PËR LËSHIMIN E PASAPORTAVE PËR JASHTË SHTETIT DHE DHËNIEN E VIZAVE"

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në dekretin nr.7393, datë 12.6.1990 "Për lëshimin e pasaportave për jashtë shtetit dhe dhënien e vizave", ndryshuar me dekretin nr.265, datë 21.7.1992, në nenin 17, dy paragrafët e fundit ndryshohen si vijon:

"Shtetasit e Zvicrës, Austrisë, Finlandës, Suedisë, Norvegjisë, Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Irlandës, Italisë, Luksenburgut, Hollandës, Portugalisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bullgarisë, Kanadasë dhe Turqisë kanë të drejtë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa qenë nevoja për t'u pajisur me vizë.

Të drejtën e mësipërme e kanë për reciprocitet edhe shtetasit e atyre shteteve që nuk kërkojnë të pajisen me vizë shtetasit shqiptarë, kur këta të fundit hyjnë në territorin e tyre".

Neni 2

Në nenin 18, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Shtetasit e Zvicrës, Austrisë, Finlandës, Suedisë, Norvegjisë, Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Spanjës, Francës, Irlandës, Italisë, Luksenburgut, Hollandës, Portugalisë, Britanisë së Madhe, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Turqisë dhe Bullgarisë paguajnë një taksë për hyrje në territorin e Republikës së Shqipërisë, e cila caktohet me dispozita të veçanta".

Neni 3

Në nenin 19, paragrafi i dytë ndryshohet si vijon:

"Organet kompetente kanë të drejtë të ndalojnë hyrjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të personave që konsiderohen të padëshirueshëm".

Neni 4

Ky dekret hyn në fuqi më datën 21.9.1994.

KUNDERFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha